



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
 Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
 Zyra e Prokurimit



611-23-1231-1-2-1/C643

KONTRATË - FURNIZIMI-KORNIZË

KUSHTET E PËRGJITHSHME, TË VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

TITULLI: Sinjalizimi vertikal dhe Horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve në Drenas, Komoran, Terstenik, Arllat, Baicë dhe Dobroshec- Projekt dy vjeçar

Numri identifikues: 611-23-1231-1-2-1, Nr. i arkivit : 400 -17740 Përgaditur ne Drenas:14.04.2023

PALËT NË MARRËVESHJE

- KOMUNA E DRENASIT - DRENAS**, përfaqësuar nga **GEZIM HAJDINI**, Zyrtar i Prokurimit (më tutje “Punëdhënës”)
- Limit L & B SH.P.K.– PRIZREN**, përfaqësuar nga **LIMAN ASLLANI** , Drejtor (me tutje “Kontraktues”)

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim **Sinjalizimi vertikal dhe Horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve në Drenas, Komoran, Terstenik, Arllat, Baicë dhe Dobroshec- Projekt dy vjeçar** . Autoriteti Kontraktues bënë blerjen vetëm në emër të vetë Autoritetit . Përdorimi i kësaj Kontrate është obliguese për të gjitha Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.]

1.2 Kontrata do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate , duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjë prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund të blejë më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara për artikull. Megjithatë, Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje sa herë që të prokurojnë mallëra; të përmendura në 1.1.

1.4 Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parapara të specifikuar dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendos të MOS blejë ASNJË nga këto sasira për disa artikuj.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 18.04.2023 dhe përfundon në datën 17.04.2025

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 3 (tri) ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: **Sinjalizimi vertikal dhe Horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve në Drenas, Komoran, Terstenik, Arllat, Baicë dhe Dobroshec- Projekt dy vjeçar** . [Vendi i dërgimin të furnizimeve do të jetë në adresën e treguar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.]

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi. Vlera totale indikative e kontratës është 1,295.00Euro me çmim te poentuar dhe vlera e përgjithshme e kontratës është 90,000.00.(Nentedhjetemije euro)

4.3 Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (b) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (c) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (d) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (e) Urdhër blerja;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtım, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Angleze] [Shqipe] [Serbe]² in në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

PJESA II E KONTRATËS

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Produktet" përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 "Autoriteti Kontraktues" do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

¹⁸ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

1.4 "Furnizues" do të thotë një person fizik ose juridik që është pale e kesaj kontrate dhe sipas dispozitave të kesaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 "Inkotermet" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 "Furnizim" do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 "Çmimi i kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 "Shërbimet pas shitjes" do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Furnizuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njezh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndhurma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë të furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syceltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrat. Ekzekutimi i urdhrat administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Siguria e ekzekutimit

8.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

8.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

8.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës së perkohshme të pranimit.

Neni 9 Sigurimi

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë të siguruar plotësisht me një valute lirisht të konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit të rastësishëm të prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj në mënyrën e specifikuar në KVK.

9.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 9.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 10 Marrëveshjet tatimore dhe doganore

10.1 Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifave doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara në vendin e dorëzimit, siç është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 11

Patentat dhe licencat

11.1 Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 12

Periudha e ekzekutimit të detyrave

12.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e lëshimit të Urdhër Blerjes, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 13.

Neni 13

Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

13.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritset se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

13.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

13.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 14

Vonesat e ekzekutimit

14.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet t'i behen Furnizuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e furnizuesit.

14.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 14.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

- a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vetë Autoritetit, me një operatore ekonomik:*
 - të konfiskojë garancinë e realizimit;
 - të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
 - të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.
- b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vetë Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*
 - të konfiskojë garancinë e realizimit;
 - të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
 - të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porposine anulon porosine dhe ritenderon, dhe ne kete rast Furnizuesi nuk do te ketë te drejte për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë te drejte për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 15 Suspendimi

15.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

15.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

15.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

15.4 Furnizues nuk do të ketë te drejte për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrimit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

15.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

15.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

15.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtjesore, parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

15.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtjesore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16 Cilësia e furnizimeve

16.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform

ne te gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kerkesat tjera ne kontrate, te cilat duhet te mbahen ne dispozicion te Autoritetit kontraktues per qellime identifikimi gjate periudhes se realizimit te kontrates.

16.2 Te gjitha pranimet teknike preliminare te parapara ne KVK duhet te behen me kerkesa te derguar nga furnizuesi per autoritetin kontraktues. Ne kerkesa do te saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara per këte pranim sipas kontrates dhe te tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do te bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuara në kerkesa duhet te certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kerkesat per këte pranim para se te inkorporohen ne furnizime.

16.3 Edhe nese materialet apo artikujt qe do te inkorporohen ne furnizime ose ne prodhim te komponenteve qe do te furnizohen jane pranuar teknikisht ne këte mënyrë, ato prapë mund te refuzohen nese ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe ne këte rast ato duhet te ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt qe janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do te pranohen per inkorporim ne furnizime vetëm nese janë riparuar dhe janë përmirësuar ne atë mënyrë qe te jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 17

Inspektimi dhe testimi

17.1 Furnizues do te sigurojë qe furnizimet te dorëzohen ne vendin e pranimit me kohë qe t'i mundësohet autoritetit kontraktues te vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka parapare plotësisht veshtrësitë qe mund t'i hasë ne këte aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet qe te paraqesë ndonjë arsye per vonesë.

17.2 Autoriteti kontraktues do te ketë te drejtë qe herë pas here te inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe te kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit te çfarëdo artikulli qe përgatitet, fabrikohet ose prodhohet per t'u dorëzuar sipas kontrates, ne mënyrë qe te përcaktojë nese komponentët, materialet dhe mjeshtrëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do te bëhet ne vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose ne vendin e pranimit apo ne vendet qe janë specifikuar ne KVK.

17.3 Per qellime te testimeve dhe inspektimeve te tilla, Furnizues do te:

- a) I japë autoritetit kontraktues, perkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë per testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe te dhëna te prodhimit qe zakonisht kërkohen per inspektim dhe testim;
- b) Te merret vesh me autoritetin kontraktues per vendin dhe kohën e testimeve;
- c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje ne çfarëdo kohe te arsyeshme ne vendin ku do te realizohen testimet.

17.4 Nese përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent ne datën e vendosur per testim, furnizuesi mundet qe, përveç nese ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, te vazhdojë testimin, i cili do te konsiderohet se është bërë ne prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuara si duhet te rezultateve te testit te Autoritetit kontraktues, nese nuk ka qenë prezent gjate testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

17.5 Nese komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këte.

17.6 Nese autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen per rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund te kërkojnë qe këto teste te përsëriten ne te njëjtat kushte dhe rrethana, ose nese ndonjëra palë kërkon, te testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje te ndërsjellë. Te gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do te jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do te bartet nga pala pikëpamja e se cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

17.7 Gjatë realizimit te detyrave te tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave te paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes se prodhimit dhe operimit, te cilat informata i kanë marrë gjate inspektimit dhe testimit.

Neni 18 Parimet te përgjithshme te pagesave

18.1 Pagesat do te behen ne Euro. Pagesat qe duhet te behen sipas fatures se lëshuar nga Furnizues do te behen ne llogarinë bankare te dhënë ne Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate qe e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, qe i bashkëngjitet kerkesës per pagesë, duhet te përdoret per t'i raportuar ndryshimet ne llogarinë bankare.

18.2 Shumat duhet te paguhen brenda jo me shumë se 30 ditësh kalendarike nga data ne te cilën kerkesa e pranueshme per pagesë është regjistruar nga departamenti perkates. Data e pagesës do te jetë data ne te cilën debitet llogaria e institucionit. Kerkesa per pagesë nuk do te jetë e pranueshme nese nuk plotësohen një ose me shumë nga kerkesat thelbësore.

18.3 Periudha prej 30-ditësh mund te pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin qe kerkesa per pagesë nuk mund te plotësohet sepse shuma nuk do te paguhet per shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi qe shpenzimi mund te mos jetë legjitim. Ne rastin e fundit mund te bëhet një inspektim i menjëhershëm per qellim te

kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

18.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 18.2, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

18.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

18.6 Në rast se Autoriteti Kontraktues është duke blerë në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese, dhe nëse një autoritet kontraktues nuk plotëson obligimet e tij sipas kësaj kontrate sidomos obligimet e Nenit 18.2 furnizuesi mund të informojë APP-në për shkelje të tillë. APP mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i ndonjë dhe i të gjitha kontratave të përbashkëta kornizë të konkluduara nga APP.

Neni 19

Dorëzimi

19.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

19.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë tranzitit.

19.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

19.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimit të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

19.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 20

Operacionet e verifikimit

20.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

20.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhrë, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjeshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshhtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

20.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuar. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbrësë nga paratë që do të paguhet ose të cilat do të bëhen obligim për t'iu paguar Furnizuesit.

20.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimit, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të

turnizuesit. 1 e gjitha punet qe pertshjne materialet e retuara do te retuzohen.

Neni 21 Pranimi i përkohshëm

21.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimi të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

21.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimi të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njëres nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimi të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

21.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimi ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

21.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimi të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimi të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimi përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

21.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

21.6 Pas pranimi të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimi siç kërkohen në kontratë.

Neni 22 Obligimet për garanci

22.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshhtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

22.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshhtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

22.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

22.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

22.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse konhezagjatja e periudhes së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 23 Shërbimet pas-shitjes

23.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 24 Pranimi përfundimtar

24.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 22 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

24.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

24.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parrealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 25 Shkelja e kontratës

25.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

25.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

25.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

25.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 26 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

26.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbytjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përmbytjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e parapare në legjislacionin apo në

rregulloret nacionale;

- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

26.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

26.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmblyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

26.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

26.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

26.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 27 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

27.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

27.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

27.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 27.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 28

Forca madhore

28.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

28.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me

kujdesin e duhur.

28.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 14 dhe 26, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 18.4 dhe 27, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

28.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasë ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e shihet të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 30 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

30.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.





Kushtet e Përgjithshme të Kontratës	Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK	
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Komunikimet dhe Gjuha e përdorur	2.2	<p>Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe. Komunikimi mes Autoritetit Kontraktues dhe kontraktuesit do të bëhet vetëm përmes përfaqësuesve të palëve nënshkruese apo personave të autorizuar nga palët nënshkruese të kësaj kontrate.</p> <p>Kudo që këto Kushte sigurojnë dhënien apo lëshimin e aprovimeve, çertifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve dhe kërkesave, këto komunikime do të jenë:</p> <p>(a) me shkrim dhe të dërgohen me dorë (përkundër dëftesave), të dërgohen përmes postës apo korierit, ose të transmetohen duke përdorur me pajtım çfardo sistemesh të transmetimit elektronik; dhe</p> <p>(b) të dërgohen, çohen apo transmetohen në adresën për komunikimet e pranuesit siç është shpallur në Kontratë. Sidoqoftë:</p> <p>(c) nëse pranuesi njofton për një adresë tjetër, komunikimet që andej e tutje duhet të dërgohen në përputhje me rrethanat; dhe</p> <p>(d) nëse pranuesi nuk e ka shpallur ndryshe kur ka kërkuar një aprovim apo pëlqim, mund të dërgohet në adresën prej së cilës është lëshuar kërkesa.</p> <p>Aprovimet, çertifikatat, pëlqimet dhe përcaktimet nuk duhet të mbahen apo vonohen pa arsye.</p> <p>Kontraktuesi nuk duhet që, pa pëlqimin paraprak të autoritetit kontraktues, të anuloj caktimin e Përfaqësuesit të Kontraktuesit – personin e autorizuar apo të bëj një zëvendësim.</p> <p>Përfaqësuesi i Kontraktuesit duhet që, në emër të Kontraktuesit, të pranoj udhëzimet sipas kësaj kontrate</p> <p>Përfaqësuesi i Kontraktuesit mund të delegoj çfardo fuqie, funksioni dhe autoriteti cilido personi kompetent dhe mund që gjatë çfardo kohe të anuloj delegimin. Çfardo delegimi apo anulimi nuk do të hyjë në fuqi dërsia autoriteti kontraktues të ketë marrë njoftim paraprak të nënshkruar nga Përfaqësuesi i Kontraktuesit, duke emëruar personin dhe specifikuar fuqit, funksionet dhe autoritetin e deleguar apo të anuluar. Përfaqësuesi i Kontraktuesit dhe të gjithë këta persona duhet të jenë të rrjedhshëm në gjuhën për komunikimet e definuara në kete kontrat .</p>
Obligimet e Kontraktuesit	2,3	<p>Kontraktuesi do t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, Ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtım paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Nëse shfaqet ndonjë mosmarrëveshje lidhur me nevojën për publikim ose shpalosje për qëllime të kontratës, vendimi i Autoritetit kontraktues do të jetë final. Të gjitha furnizimet duhet t'i kryej konform specifikimeve teknike dhe çmimorës si dhe obligimet tjera që janë specifikuar në dosje të tenderit.</p>
Programi i realizimit	2.4	<p>Institucionet e komunës nëpërmes Kryetarit të komunës obligohet që të caktojë Menaxher të projektit personin me përvojë dhe mundësisht nga Institucionet e komunës duhet të hartojnë Planin e menaxhimit të kontratës konform nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për mbikqyrjen dhe raportimin për furnizimet e kryera.</p>
Menaxhimi	2.5	<p>Menaxheri i caktuar ka për obligim që OE furnizues ta përcjellë realizimin e kontratës dhe kryerjen e furnizimeve ashtu është precizuar në dosjen e tenderit.</p>
Siguria e ekzekutimit	8.1	<p>Shuma e sigurise se ekzekutimit është 10 % e shumës së vlerës së Kontratës dhe do të jetë valid 25 muaj. Siguria e ekzekutimit duhet të ofrohet nga OE në ditën e hyrjes në fuqi së kontratës.</p> <p>Kontraktuesi duhet të përfundoj furnizimet sipas datës së paraparë në nenin paraprak në afat deri : (24 muaj) dhe të dorëzoj raportin përfundimtar të furnizimeve të kryera në në fund të çdo muaji ku duhet të përmbahen të gjitha detajet për furnizimet e kryera dhe Organin Mbykqyres me një Vendim tjetër.</p>

Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	8.2	<p>Kreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jënë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Mjetet motorike të Palës së Tretë: sipas ligjeve në fuqi Përgjegjësia e pales së tretë sipas ligjeve në fuqi Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve sipas ligjeve në fuqi Përgjegjësia profesionale sipas ligjeve në fuqi Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve sipas ligjeve në fuqi <p>Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit që ne baze të kontratës i takojnë Kontraktuesit, Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues dhe DSHPE nga ankesat dhe dëmet tjera të shkaktuara nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.</p>
Pagesat	8.3	<p>Për t'i marrë pagesat, Kontraktuesi duhet t'i përcjellë Autoritetit të përmendur në paragrafin 26.1 më lart:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kontraktuesi obligohet që për furnizimet e kryera në muajin e kaluar, Faturën ta dorëzojë nga data 01 deri 05 e muajit në vazhdim ose në momentin e kryejrjes së furnizimeve. Pagesa duhet të kryhet mundësisht menjëherë, nëse jo atëherë jo më vonë se tridhjetë ditë pas dorëzimit dhe pranimit të faturës.
Sigurimi	9.1	<p>OE obligohet që Sinjalizimi vertikal dhe Horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve në Drenas, Komoran, Terstenik, Arllat, Baicë dhe Dobroshec- Projekt dy vjeçar ta sigurojë gjatë bartjes dhe transportit deri në dorëzimin final.</p>
Cilësia e furnizimeve	16.2	<p>Sinjalizimi vertikal dhe Horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve në Drenas, Komoran, Terstenik, Arllat, Baicë dhe Dobroshec- Projekt dy vjeçar-Kontratë Kornizë për tri vite duhet të jetë i përfunduar ashtu si shkruan në specifikacionin e prodhuesit. Furnizimet duhet të kryhen Konform standardeve të kërkuara në dosje të tenderit. Nëse furnizimet janë të dobëta dhe pas tërheqjes së vërejtjes ato përsëri janë të tilla, atëherë fillohet me uljen e pagesave mujore dhe nëse prapë vazhdohet atëherë kontrata njëanshëm ndërpritet.</p>
Inspektimi dhe testimi	17.2	<p>Çdo herë para se të pranohet apo sipas nevojave.</p>
Dorëzimi	19.3	<p>Sinjalizimi vertikal dhe Horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve në Drenas, Komoran, Terstenik, Arllat, Baicë dhe Dobroshec- Projekt dy vjeçar -Kontratë Kornizë për tri vite duhet të jënë të paketuara dhe të bashkangjitur me specifikimet dhe udhëzimet nga prodhuesi dhe të dorëzohen te Depoisti Komunal).</p>
Obligimet e garancionit	22.1	<p>Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, me afat të përdorimit. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.</p>
Obligimet tjera të kontraktuesit	22.5	<p>Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit që ne baze të kontratës i takojnë Kontraktuesit, Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Zyrtarin e prokurimit nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Kontraktuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.</p>
Dëmet e likuiduara	22.6	<p>Dëmet e likuiduara për të gjitha Furnizimet janë 0.25 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Furnizimet është 10 % e Çmimit final të Kontratës. e. Furnizimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 ditë pas pranimit të kërkesës nga Njësia kërkuuese.</p>
Monitorimi	22.7	<p>Menaxheri i projektit obligohet që monitorimin e kontratës në aspektin Ligjor herë pas here ta kryej konform neneve të kontratës dhe ligjeve në fuqi dhe duhet të bindet se kontrata implementohet ashtu edhe si është hartuar. Poshtu merrë përsipër së bashku me Avokatin komunal të përballet edhe me pengesat eventuale dhe mbrojtjen e kontratës dhe interesave të Komunës para institucioneve tjera.</p>

Parapagimi	22.8	Shuma e parapagimit (avans) : 0
Mbajtja e Parasë	22.9	Shuma e parave të mbajtura është: 0 %
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	22.10	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e furnizimeve, është plus 10 % e vlerës së kontratës ose nëse dëmi është i madh deri në vlerën e përgjithshme të kontratës. Poashtu nëse kontrata ndërpritet me fajin e Autoritetit kontraktues atëherë Menaxheri jep urdhër për pagesë për të gjitha punët e kryera dhe të papaguara.
Furnizimet pas shitjes	23.1	Furizimi do të kryhet – SIPAS KERKESES SE MENAXHERIT TE KONTRATES
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Mundesisht ne mes te dy palëve..
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në pajtim me ligjin në Kosovë.
Mbikëqyrja	31.0	Mbikëqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marrë pjesë në hartimin e paramasave ose specifikimeve dhe as Ai që ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave.
Furnizime shtesë	31.1	
Pagesat	31.2	Të gjitha pagesat bëhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës për shërbimet e kryera mujore.
Dorëzimi i dokumentave	31.3	Zyrtari për pagesë para se t'i kryej pagesat duhet të bindet se ju kanë ofruar të gjitha dokumentet si: Plani i menaxhimit të kontratës , aktvendimet, procesverbalet, raportet, pranimet, urdhëresat, faturat, shkresat, etj.
Arkimi i dokumentave	31.4	Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblertes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë. Një kopje e faturës, raportit të pranimit dhe kontratës pas përfundimit të projektit duhet të dorëzohen tek Zyrtarja për rexhistrimin e pasurisë.
Hyrja në fuqi	31.5	Kontrata hynë në fuqi me MENJEHRE PAS NENSHKRIMI TE Kontrates hartohet në 2 kopje origjinale.

Bashkangjitur: Oferta financiare e artikujve ushqimor.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	GEZIM HAJDINI	Emri:	LIMAN ASLLANI
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	18.04.2023	Data:	18.04.2023
Vula:		Vula:	



Garanci Ekzekutimi



Serial 070030060014151

Për **KOMUNA GLLOGOC**

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PASUR PARASYSH QË

LIMIT L&B SH.P.K.

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marre përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

ne Horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve në Drenas, Komoran, Terstenik, Arllat, Baicë dhe Dobrosht

të dhënë me numrin e Prokurimit.

611-23-1231-1-2-1

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

€ 9,000.00

Nent mije €

(shuma e garancisë në shifra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoritetit kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumat brenda limiteve të

€ 9,000.00

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen

(shuma e garancisë)

arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

18.04.2023

deri më

17.05.2025

Lëshuar në

Dega Prizren

datë

18.04.2023

Nënshkrim dhe vula e Garantuesit

SIGAL UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA
Agjenti: Pranvera Shehu

KONTRATË KORNIZË DY VJEQARE

PARAMASA SHENJËZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGËVE DHE VENDBANIMEVE, Drenas, Komoran, Arllat, Baicë Dobroshec etj

Sasia e kontraktuar

Nr.	Lloji i Panelës	Njesia	Sasia	Qmimi	Gjithsej	Peshimi në %
1	<p>Furnizimi dhe montimi i panelave trekëndëshe ,komplet me shtyllë dhe dy lidhëse, dhe me kualitet të filmit "3M Scotchlite Diamond Grade" – madhësia 600x600x600[mm] –në çmim duhet të përfshihen:</p> <p>Furnizimi e panelës, shtyllës. Lidhëseve, betonit, dhe gërmimi i dheut (0.4x0.3)m për vendosje të shtyllës. Montimi i panelës duhet të bëhet në lartësi minimale nga toka prej 2200 [mm] edhe nese duhet të vendosën shënjat ndihmëse;</p> <p>Vendosja e panelës dhe shtylles të bëhet më bazament të betonit si në fig.10</p> <p>Vizatimi në filmin e panelës të bëhen sipas Konventës së Vienës.</p>	copë	1	45.00	45.00	90%
2	<p>Furnizimi dhe montimi i panelave rrethore ,komplet me shtyllë dhe dy lidhëse, dhe me kualitet të filmit "3M Scotchlite Diamond Grade" – madhësia Ø600 [mm] –në çmim duhet të përfshihen:</p> <p>Furnizimi e panelës, shtyllës. Lidhëseve, betonit, dhe gërmimi i dheut (0.4x0.3)m për vendosje të shtyllës. Montimi i panelës duhet të bëhet në lartësi minimale nga toka prej 2200 [mm] edhe nese duhet të vendosën shënjat ndihmëse;</p> <p>Vendosja e panelës dhe shtylles të bëhet me bazament betoni si në fig.10</p> <p>Vizatimi në filmin e panelës të bëhen sipas Konventës së Vienës.</p>	copë	1	50.00	50.00	90%
3	<p>Furnizimi dhe montimi i panelave drejtkendore, komplet me shtyllë dhe dy lidhëse me kualitet të filmit "3M Scotchlite Diamond Grade" madhësia 600x600[mm] , në këtë tip të shenjave hynë edhe shenjat për ndalim i detyrueshëm (STOP).</p> <p>Në çmim të kalkulohet : furnizimi i panelës, shtyllës, me dy lidhëse, betoni, dhe gërmimi i dheut (0.4x0.3)m për vendosje të shtyllës. Montimi i panelës duhet të bëhet në lartësi minimale nga toka prej 2200 [mm] edhe nese duhet të vendosën shënjat ndihmëse;</p> <p>Vendosja e panelës dhe shtyllës në beton të përforcuar si në fig .10.</p> <p>Vizatimi në filmin e panelës të bëhen sipas Konventës së Vienës.</p>	copë	1	50.00	50.00	90%
4	<p>Furnizimi dhe montimi i panelave drejtkendore, komplet me shtyllë dhe dy lidhëse me kualitet të filmit "3M Scotchlite Diamond Grade" madhësia 600x900[mm] .</p> <p>Në çmim të kalkulohet : furnizimi i panelës, shtyllës, me dy lidhëse, betoni, dhe gërmimi i dheut (0.4x0.3)m për vendosje të shtyllës. Montimi i panelës duhet të bëhet në lartësi minimale nga toka prej 2200 [mm] edhe nese duhet të vendosën shënjat ndihmëse;</p> <p>Vendosja e panelës dhe shtyllës në beton të përforcuar si në fig .10.</p> <p>Vizatimi në filmin e panelës të bëhen sipas Konventës së Vienës.</p> <p>Vendosja e panelës dhe shtyllës në beton të përforcuar.</p>	copë	1	30.00	30.00	90%
5	<p>Furnizimi dhe montimi i panelave të kryqit të andreut komplet me lidhese dhe shtyllë me kualitet të filmit "3M Scotchlite Diamond Grade" në çmim përfshihen edhe:</p> <p>Furnizimi i panelës, shtyllës, Lidhëseve, betonit si ne fig.10, dhe gërmimi i dheut (0.4x0.3)m për vendosje të shtyllës. Montimi i panelës duhet të bëhet në lartësi minimale nga toka prej 2200 [mm] edhe nese duhet të vendosën shënjat ndihmëse;</p>	copë	1	10.00	10.00	90%

6	<p>Furnizimi dhe montimi i panelave drejtkendore së bashku me katër lidhese dhe shtylla (dy shtylla në një shenjë) me kualitet të filmit "3M Scotchlite Diamond Grade" – madhësia 600-1200 (mm)(Vendbanimeve) – çmimi përfshinë:</p> <p>Furnizimi e panelës, shtyllës, lidhëseve, betonit i bazamentit si në fig 10., dhe gërmimi i dheut (0.4x0.3)m për vendosje të shtyllës. Montimi i panelës duhet të bëhet në lartësi minimale nga toka prej 2200 (mm). Për vendosjene këtyre shenjave nevojiten nga dy shtylla për shenjë.</p> <p>Vizatimi në filmin e panelës të bëhen sipas Konventës së Vienës.</p>	copë	1	38.00	38.00	90%
7	<p>Furnizimi dhe montimin e panelave drejtkendore se bashku me dy lidhese dhe shtylla të perforcuar në beton me kualitet të filmit "3M Scotchlite Diamond Grade" me dim. 300x1000-(tek hekurudhat).Në çmim përfshinë:</p> <p>Furnizimi e panelës, shtyllës, lidhëseve, betonit si në fig.10., dhe gërmimi i dheut (0.4x0.3)m për vendosje të shtyllës. Montimi i panelës duhet të bëhet në lartësi minimale nga toka prej 2200 [mm]</p> <p>Vizatimi në filmin e panelës të bëhen sipas Konventës së Vienës.</p>	copë	1	10.00	10.00	90%
8	<p>Furnizimi dhe montimi i tabelave udhëtrëguese së bashku me katër lidhese dhe shtylla(dy shtylla në shenjë) të perforcuara në beton si në fig 10., tabela ka formen e shigjetes materialet e filmit duhet të jenë të kualitetit " High Intensity Grade" Pllak alumini 2 (mm) madhësia 1300x450(mm) Teksti caktohet nga ana e Komunës, në çmim përfshinë:</p> <p>Furnizimi e panelës, shtyllës, lidhëseve, betonit, dhe gërmimi i dheut (0.4x0.3)m për vendosje të shtyllës. Montimi i panelës duhet të bëhet në lartësi minimale nga toka prej 2200 [mm]</p> <p>Vizatimi në filmin e panelës të bëhen sipas Konventës së Vienës.</p>	cope	1	38.00	38.00	90%
9	<p>Drejtimi me libel në pozitë vertikale saktë të drejtë , të shtyllave për shenja trafiku, përfshirë furnizimin dhe vendosjen e shtyllës, gërmimi i dheut (0.4x0.3)m si dhe bazamenti i betonit si në fig. 10.</p>	copë	1	20.00	20.00	90%
10	<p>Largimi i panelave të demtuara të trafikut nga shtyllat ekzistuese, rimontime, larja dhe fshirja , ndërimi i lidheseve të demtuara të shenjave .</p>	copë	1	1.00	1.00	90%
11	<p>Furnizimi me ngjyrë dhe punimi i vijës së aksit rrugor me gjersi B=15 cm, Ngjyra duhet të jetë dy komponentëshe(e paisur me grimca të qelqit) e qëndrueshme ndaj temperaturave dhe kushteve tjera klimatike. Në çmim duhet të përfshihen edhe piketimet për vendosjen e vijës së aksit të rrugës. Vërejtje: Para fillimit të punimit të vijës së bardhë duhet të sillen atestet paraprake të ngjyrës, trashësia e masës plastike duhet të jetë 2 mm dhe me sasi të grimcave reflektuese 300g/m². Në çmim llogaritet vetëm vija punuese.</p>	m ²	1	5.00	5.00	90%
12	<p>Furnizimi me ngjyrë dhe punimi i numrave të parkingjeve, ngjyra duhet të jetë dy komponentëshe (e paisur me grimca të qelqit) me dimensione standarde teknike. Të realizohet sipas standarteve në përshkrimin teknik.</p>	copë	1	5.00	5.00	90%
13	<p>Furnizimi me ngjyrë dhe punimi i Vendkalimit për kembësor (zebrave) sipas standardeve dhe normave teknike të komunikacionit , Ngjyra duhet të jetë dy komponentëshe(e paisur me grimca të qelqit, me ngjyrë të bardhë, verdhë , Kuqe),trashësia e masës plastike duhet të jetë 2 mm dhe me sasi të grimcave reflektuese 300g/m². e qëndrueshme ndaj temperaturave dhe kushteve tjera klimatike.</p>	m ²	1	20.00	20.00	90%

14	Furnizimi me ngjyrë dhe punimi i shenjave horizontal në rrugë me mbishkrimet(BUS, SHKOLLA, TAXI,MDALIM PARKINGU,PERSONA ME AFTESI TË KUFIZUARA etj), sipas standardeve dhe normave teknike të komunikacionit , Ngjyra duhet të jetë dy komponentëshe(e paisur me grimca të qelqit ky ngjyra e vijes duhet të jetë verdhë,e kuqe, e bardh, ose kaltërt ,sipas nevojës se shenjës)trashësia e masës plastike duhet të jetë 2 mm dhe me sasi të grimcave reflektuese 300g/m ² . e qëndrueshme ndaj temperaturave dhe kushteve tjera klimatike. Të realizohet sipas standarteve në përshkrimin teknik.	copë	1	1.00	1.00	90%
15	Furnizimi me ngjyrë dhe punimi i shenjeimit horizontal të vendparkingjeve për automjete (autobus, vetura etj), sipas standardeve dhe normave teknike të projektimit , ngjyra duhet të jetë e bardhë kurse vëndparkingu për përsona me aftësi të kufizuara duhet të jetë sipas figurës në përshkrim teknik një komponentëshe(e paisur me grimca të qelqit) e qëndrueshme ndaj temperaturave dhe kushteve tjera klimatike. Gjersësia minimale nga (10 cm).	m'	1	1.00	1.00	90%
16	Furnizimi me ngjyrë dhe punimi i shenjeimit horizontal i shigjetave orjentuese sipas standardeve dhe normave teknike të komunikacionit , Ngjyra duhet të jetë e bardh dy komponentëshe(e paisur me grimca të qelqit) trashësia e masës plastike duhet të jetë 2 mm dhe me sasi të grimcave reflektuese 300g/m ² . e qëndrueshme ndaj temperaturave dhe kushteve tjera klimatike. Të realizohet sipas standarteve në përshkrimin teknik.	Copë	1	10.00	10.00	90%
17	Furnizimi me ngjyrë dhe punimi i shenjeimit horizontal i ishujve sipas standardeve dhe normave teknike të komunikacionit , Ngjyra duhet të jetë e bardh një komponentëshe(e paisur me grimca të qelqit) e qëndrueshme ndaj temperaturave dhe kushteve tjera klimatike.	m ²	1	1.00	1.00	90%
18	Furnizimi dhe montimi i shtyllave te plastikes, keto pengesa duhet te jenë nga materiali i plastikes. Të gjitha pjesët duhet të jenë të mbrojtura nga rreshjet atmosferike dhe nga goditjet e jashtme të jetë elastike dhe me ngjyrë të cilën e cakton menaxheri i projektit në dimensione minimale: Diametri i jashtëm : 700 mm ose 1000 mm, 2. Diametri i mbrendshëm: Ø80xØ96x 4mm, Pesha: 1.5kg deri 2 kg sipas standardit EN 12899-3:2007, vendosja e pengesës dhe shtrengimin e saj me bulona M12, me gjatësi të bulonave deri në 24 cm në funksion të trashësisë së konstruksionit të rrugës dhe mbushja e hapsirës.	Copë	1	10.00	10.00	90%
19	Furnizimi dhe montimi i Shtyllave metalike Anti Parking Ø100 mm, prej materialit të zinguar trashësia e murit 2.2 mm dhe lartësi L= 1.2m nga baza,ndërsa gjatësia totale e saj duhet të jetë 1.5 m, në çmim duhet hyjë groposja në thellësi prej 30 cm, montimi dhe betonimi. Shtylla duhet të ketë edhe folie adezie vizulluse dhe ndriqese.	copë	1	30.00	30.00	90%

20	Furnizimi dhe montimi i tabelave drejtkëndore e filmit duhet të jenë të kualitetit " High Intensity Grade" Pllak alumini 2 (mm) madhesia 600x250(mm) Teksti caktohet nga ana e Komunës, në qmim përfshin: Furnizimi e panelës, shtyllës, Lidhëse, betonit për bazament si në fig 10, dhe gërmimi i dheut për vendosje të shtyllës. Montimi i panelës duhet të bëhet në lartësi minimale nga toka prej 1200 [mm] Vizatimi në filmin e panelës të bëhen sipas Konventës së Vienës.	copë	1	5.00	5.00	90%
21	Furnizimi dhe montimi i shenjave udhëtrëguese(udhërrëfyese) nga materiali i plastikes (PVC)me dimensione 12x1200 [cm] me trashësi të mureve (5 mm),montimi i tyre bëhet në tokë me standarde të normave teknike. Sinjalizimi të jetë me material adeziv ndriqes sipas figures nr.12.	copë	1	5.00	5.00	90%
22	Furnizimi dhe montimi i shtyllës metalike të qelikut të galvanizur/zingtuar/ me standarde teknike , për shenjëzim gjysem portal në vendkalimet për këmbësor, si me poshte: Dimenzioni i shtyllës duhet të jetë -diametri Ø 193 mm me trashësi të murit (4 mm) dhe lartësi (5.2 m) nga baza , në qmim të hyjë edhe hapja e kanalit / themejt/ për shtyllë me dimensione [1.2x1.2x1 m], kallopimi, betonimi bazamentit të armiruar si dhe hapja e kanalit për vendosje të kablilit (20-40)m, dhe këtu të hyjë edhe demolimi/prerja/ e kubzave, betonit dhe asfaltit, dhe kthimi në gjendje të me parshme.Të realizohet sipas standardeve në përshkrimin teknik.	copë	1	400	400	90%
23	Furnizimi dhe montimi i krahut nga materiali i metalit të qelikut të galvanizur/zingtuar/ me standarde teknike. Dimenzioni i krahut: gjatësia horizontale (4 m),(diametri Ø 90 mm me trashësi të murit 3 mm dhe lartësia e krahut h=1.41 m), krahu duhet të saldohet në shtyllën kryesore dhe shtrihen në kahjen e drejtimit të rrugës.Të realizohet sipas standardeve në përshkrimin teknik.	copë	1	200	200	90%
24	Furnizimi, montimi i panelit sinjalizues me këto karakteristika: 1) Dimenzioni:1300x1000 mm, 2)Ndriqimi i panelit/shenjes, me ndriqim LED sipas standardit UNI EN 12899 Class L2, 3) Temperatura e ngjyrës (5000-6000) K, 4)Furnizimi me energji me kablil 3x2.5 mm ² (20-40)m, 5) Shenja/ vendkalimi i shenuar për këmbësor të jetë dy anësor me 3M, diamond grade,6) Paneli duhet të jetë i parafabrikuar me kornizë nga Alumini dhe shkallë të mbrojtjes IP 54, Shih përshkrimin teknik.	copë	1	145	145	90%
25	Furnizimi, montimi i dritave sinaizuese LED vezulluese, duhet të jetë më këto karakteristika: 1) Diemzioni φ (198x25) mm, 2)Material nga polikarboni, 3) Tipi i poqit ndriqes (LED, të jetë brend i njohur), me fuqi 11w me shkallë të IP 66,dhe furnizim me 12 VDC.Shih përshkrimin teknik.	copë	1	50	50	90%
26	Furnizimi, montimi i reflektorit LED, duhet të jetë më këto karakteristika: 1) Diemzioni (1000x80x175) mm, 2)Material nga alumini, 3) Tipi i poqit ndriqes (LED, të jetë brend i njohur), me fuqi 55 w me shkallë të IP 66, jetëgjatësi 100,000 hrs, temperatura e ngjyrës 5500 K dhe pesha e përafert 4.5 kg.Shih përshkrimin teknik.	copë	1	95	95	90%
Totali A					1,275.00	

	Mirëmbajtja e luars					
27	Çdo gjashtë muaj kontrolli dhe shtëm të yndyrës (kallamazit)	copë	1	450.00	450.00	10%
28	Çdo gjashtë muaj kontrollimi dhe shtëmi i vajit A220.	copë	1	450.00	450.00	10%
29	Kartela RFID	copë	1	50.00	50.00	10%
30	Mbajtja metalike e Horizontalës	copë	1	5.00	5.00	10%
31	Mbajtja metalik i Lexuesve	copë	1	5.00	5.00	10%
32	Drita Fleshuese	copë	1	5.00	5.00	10%
33	Senzoret e sigurisë	copë	1	5.00	5.00	10%
34	Nul	copë	1	5.00	5.00	10%
35	Spring washer	copë	1	5.00	5.00	10%
36	Bolt washer	copë	1	5.00	5.00	10%
37	Expansion bolt	copë	1	5.00	5.00	10%
38	Cover	copë	1	5.00	5.00	10%
39	Bar	copë	1	5.00	5.00	10%
40	Bar cover	copë	1	5.00	5.00	10%
41	M4 Screw	copë	1	5.00	5.00	10%
42	M10 Screw	copë	1	5.00	5.00	10%
43	Bar locking branck	copë	1	5.00	5.00	10%
44	bar suport	copë	1	5.00	5.00	10%
45	Proximity switch	copë	1	5.00	5.00	10%
46	M6 screw	copë	1	5.00	5.00	10%
47	Driven lever	copë	1	5.00	5.00	10%
48	Upperrubber pad	copë	1	5.00	5.00	10%
49	M10 screw	copë	1	5.00	5.00	10%
50	Spring adjusting rot	copë	1	5.00	5.00	10%
51	Balancing spring	copë	1	5.00	5.00	10%
52	Pin	copë	1	5.00	5.00	10%
53	Rpin	copë	1	5.00	5.00	10%
54	Spring adjusting rot	copë	1	10.00	10.00	10%
55	Remote control	copë	1	20.00	20.00	10%
56	Kontrol Paneli	copë	1	200.00	200.00	10%
57	Loop Detector	copë	1	5.00	5.00	10%
58	Lexuesi i Kartelave	copë	1	5.00	5.00	10%
59	Access Control TCP/IP	copë	1	5.00	5.00	10%
60	Output shaft	copë	1	5.00	5.00	10%
61	Horizontale alumini	m'	1	30.00	30.00	10%
62	Bar cap	copë	1	5.00	5.00	10%
63	Konfigurimi i sistemit	copë	1	120.00	120.00	10%
	Totali				1,475.00	

Rikapitulim i përgjithshëm	Çmimi total	Çmimi total i peshuar
Totali A prej (1-26) me 90%	€ 1,275.00	€ 1,147.50
Totali B prej (27-63) me 10%	€ 1,475.00	€ 147.50
Totali (A+B)	€ 2,750.00	€ 1,295.00
Çmimi i përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohet në bazë të kësaj vlerë). Kjo është vlera e cila do të shënohet në formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.		€ 1,295.00

Para fillimit të vendosjes së të shënjëzimit horizontal duhet të sillen atestet e ngjyrës dhe njëherit atestet e shenjave vertikale, si dhe garancionin 2 vite nga vendosja e tyre shenjave vertikale, pa llogaritur demtimit fizik

Operatori ekonomik duhet të këtë makinë për sinjalizim horizontal me masë plastike dhe makinë për sinjalizim horizontal me ngjyrë të thejstë, dhe të dëshmohe me dokumentacion në emër të kompanisë ose të marra me qera, (që dëshmohe me kontratë)

Afrim Prokshi

MPTSH
Agjencia e Komercit dhe Tregëtisë
Kosovë